*Kukes me 28.10.2014*

# SHPALLJE PER LEVIZJE PARALELE
# DHE PER PRANIMIN NE SHERBIMIN CIVIL
# NE KATEGORINE EKZEKUTIVE

Ne zbatim te nenit 22 dhe nenit 25 te ligjit Nr.152/2013 "Statusi i Nepunesit Civil", si dhe Kreut II, IV, VI, te VKM Nr.143 date 12.03.2014, "Per proçedurat e rekrutimit, te perzgjedhjes, te periudhes se proves, per nepunesit civile te kategorise ekzekutive, te ulet dhe te meseme drejtuese", të kategorisë ekzekutive në grupin e pozicioneve te posaçem

1) 1 (nje) Specialist i Zyres se Finances ne Drejtorine Juridike dhe Finances, ne Institucionin e Keshillit te Qarkut Kukes, **kategoria III-b.**
2) 1 (nje) Specialist i Bujqesise dhe Agrikultures ne Drejtorine e Sherbimeve Rajonale, ne Institucionin e Keshillit te Qarkut Kukes**, kategoria III- b.**

*Pozicioni me siper, u ofrohet nepunesve te se njejtes kategori per proçeduren e levizjes paralele. Vetem ne rast se ne perfundim te proçedures se levizjes paralele, rezulton se ky pozicion eshte vakant, ai eshte i vlefshem per konkurim nepermjet proçedures se pranimit ne sherbimin civil per kategorine ekzekutive.*

**Per te dy proçedurat: (levizje paralele dhe pranim ne sherbimin civil per kategorine ekzekutive) aplikohet ne te njejten kohe.**

Afati per dorezimin e dokumentave 27 Nentor 2014

**Qellimi i pergjithshem i pozicionit te punes**:

1) Specialist i Zyres se Finances: Rakordon dhe kontabilizon dokumentat e magazines, përgatit dokumentat e mbylljes së buxhetit dhe rakordon me të gjithë treguesit e shpenzimeve sipas të dhenave të kontabilitetit.

2) Specialisti i fushes se Bujqesise dhe Agrikultures: Identifikon dhe jep kontribut per hatimin e politikave sektoriale te zhvillimit te bujqesise dhe agrikultures, hulumton për sigurimin dhe implementimin e programeve/aplikacioneve të reja në fushën e teknologjisë se perparuar per zhvillimin e bujqesise dhe agrikultures.

## I- Levizja paralele
Kane te drejte te aplikojne per kete proçedure vetem nepunesit civile te se njejtes kategori, ne te gjitha institucionet pjese e sherbimit civil.

### 1. Kushtet per levizjen paralele
- Te jete nepunes civil i konfirmuar, brenda se njejte kategori ( III-b)
- Te mos kete mase disiplinore ne fuqi (te vertetuar me dokument nga institucioni)
- Te kete te pakten nje vleresim pozitiv.

Kandidatet duhet te plotesojne kriteret e veçanta si vijon:

1) Te zoterojne diplome ne nivelin “Master Shkencor” ne fushen e Bujqesise dhe te Agrikultures.

2) Te zoterojne diplome ne nivelin “Master Profesional” ne degen Ekonomi-Finance

**2. Dokumentacioni, menyra dhe afati i dorezimit.**
Kandidatet duhet te dorezojne prane njesise se burimeve njerezore te Keshillit te Qarkut Kukes dokumentat e meposhtem:

- Jeteshkrimin (CV)
- Çertifikate familjare.
- Karte Identiteti (fotokopje)
- Fotokopje te diplomes (e noterizuar)
- Fotokopje e listes se notave (e noterizuar)
- Vertetim mjeko-ligjor
- Deshmi Penaliteti
- Libreze Pune (fotokopje)
- Çdo dokument tjeter qe verteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtese, vleresimet pozitive apo te tjera te permendura ne jeteshkrimin tuaj.

**Dokumentat duhet te dorezohen me poste apo drejteperdrejt ne institucionin tone, brenda dates 27 Nentor 2014.**

**3. Rezultatet per fazen e verifikimit paraprak.**

Ne daten 01.12.2014, Drejtoria e Menaxhimit te Burimeve Njerezore prane Keshillit te Qarkut Kukes do te shpalle ne portalin “Sherbimi Kombetar i Punesimit“, ne faqen e internetit dhe ne stenden e informimit te publikut, listen e kandidateve qe plotesojne levizjen paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe daten, vendin dhe oren e sakte ku do te zhvillohet intervista.
Ne te njejten date kandidatet qe nuk i plotesojne kushtet e levizjes paralele dhe kriteret e veçanta do te njoftohen individualisht nga Drejtoria e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, nepermjet adreses tuaj te e-mailit, per shkaqet e mos-kualifikimit.

**4. Fushat e njohurive, aftesite dhe cilesite mbi te cilat do te zhvillohet intervista**

Kandidat do te vleresohen ne lidhje me:

- Njohuri mbi legjislacionin per organizimin dhe funksionimin e organeve te qeverisjes vendore
- Njohuri mbi legjislacionin per nepunesin civil (ligjin Nr.152/2013)
- Njohuri mbi legjislacionin per rregullat e etikes ne administraten publike
- Njohuri mbi legjislacionin per Bujqesine dhe Agrikulturen.
- Njohuri mbi legjislacionin ne fushen e Financave

**5. Menyra e vleresimit te kandidateve**

Kandidat do te vleresohen per jeteshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushen, si dhe vleresimet pozitive. Totali i pikeve per kete vleresim eshte 40 pike.

Kandidatet gjate intervistes se strukturuar me goje do te vleresohen ne lidhje me:

- Njohurite, aftesite, kompetencen ne lidhje me pershkrimin e pozicionit te punes.
- Eksperiencen e tyre te meparshme
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmerite e tyre per karrieren.

Totali i pikeve ne perfundim te intervistes se strukturuar me goje eshte 60 pike.

**6. Data e daljes se rezultateve te konkurimit dhe menyra e komunikimit.**

Ne perfundim te vleresimit te kandidateve, Drejtoria e Menaxhimit te Burimeve Njerezore do te shpalle fituesin ne portalin "Sherbimi Kombetar i Punesimit", ne faqen zyrtare te Keshillit te Qarkut Kukes dhe ne stenden e informimit te publikut.

**II- Pranimi ne sherbimin civil ne kategorine ekzekutive.**

*Vetem ne rast se pozicioni i renditur ne fillim te kesaj shpalljeje, ne perfundim te proçedures levizje paralele, rezulton se ende eshte vakant, ai eshte i vlefshem per konkurimin e proçedures se pranimit ne sherbimin civil per kategorine ekzekutive.*

Per kete proçedure kane te drejte te aplikojne te gjithe kandidatet jashte sistemit te sherbimit civil, qe plotesojne kushtet e pergjithshme sipas nenit 21, te ligjit Nr.152/2013.

- Te jete shtetas shqiptar,
- Te kate zotesi te plote per te vepruar,
- Te zoteroje gjuhen shqipe, te shkruar dhe te folur,
- Te jete ne kushte shendetesore qe e lejojne te kryeje detyren perkatese,
- Te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje nje kundervajtje penale me dashje,
- Ndaj tij te mos jete marre mase disiplinore e largimit nga sherbimi civil.

Kandidatet duhet te plotesojne kriteret e vecanta si vijon:

- Te zoteroje diplome te nivelit, "Master Shkencor" ne fushen Bujqesise dhe Agrikultures
- Te zoteroje diplome ne nivelin "Master Profesional" ne degen Ekonomi-Finance
- Te kete aftesi te mira komunikuese dhe te jete i/e afte te punoje ne grup.
- Të ketë aftësi shumë të mira organizuese, komunikuese dhe kontrolluese
- Të njohë shumë mire parimet mbi të cilët është ndërtuar shërbimi civil, organizimi dhe funksionimi i qeverisjes vendore si dhe legjislacioni shqiptar në përgjithësi.
- Te kete mbi nje vit eksperience pune ne fushen perkatese.
- Te njohe mire programet baze ne kompjuter.
- Te kete te pakten nje vit eksperience pune ne fushen perkatese.

Kandidatet qe do te aplikojne duhet te dorezojne dokumentat si me poshte:

- Jeteshkrim standart
- Çertifikate familjare.
- Fotokopje te leternjoftimit (ID)
- Fotokopje te diplomes (e noterizuar)
- Fotokopje e listes se notave (e noterizuar)
- Vertetim mjeko-ligjor
- Deshmi Penaliteti
- Libreze Pune (fotokopje)
- Çdo dokument tjeter qe verteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtese ose te tjera te permendura ne jeteshkrimin tuaj.

Pas verifikimit paraprak te dokumentacionit te paraqitur nga kandidatet ne Keshillin e Qarkut Kukes, Drejtoria e Menaxhimit te Burimeve Njerezore me date 01.12.2014 do te shpalle listen e kandidateve, qe plotesojne kerkesat e pergjitheshme dhe te veçanta te cilet do te vazhdojne konkurimin per ne fazen e dyte ne portalin "Sherbimi Kombetar i Punesimit", ne faqen zyrtare te Keshillit te Qarkut Kukes dhe ne stenden e informimit te publikut ne institucion.

**Lista do te permbaje:**

1. Daten e daljes se rezultateve te verifikimit paraprak,
2. Daten, vendin dhe oren ku do te zhvillohet konkurimi,
3. Menyren e vleresimit te kandidateve.